



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:008767

Datë: 23.09.2024

Numri i dokumentit: 06242710

KF.nr.483/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “A.V.” B.I. të cilin e përfaqëson me autorizim Avokat Florin Lata, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut, me seli në rrugën “Bedri Gjinaj”, Mitrovicë Jugut, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Arbnor Murturi, lidhur me padinë e paditësit për shkak të heshtjes administrative, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësueses të autorizuar të palës paditëse Avokat Florin Lata dhe përfaqësuesit të të paditurës Avokat Arbnor Murturi, me datë 13.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A.V. B.I, si e bazuar.
- II. ANULOHET si joligjore fatura nr.18/1127 e datës 31.03.2019 e lëshuar nga e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
- III. Ky Aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë më 15.01.2021, ka inicuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës, Komunës së Mitrovicës, duke kërkuar anulimin si të jashtëligjshëm të faturës nr. 18/2017 të datës 31.03.2019. Përfaqësuesi i paditësit, si në padi ashtu edhe gjatë seancës gjyqësore, deklaroi se e paditura nuk ka vepruar sipas aktgjykimit A.nr.2126/18 të datës 05.10.2020, ku ishte obliguar që brenda 30 ditëve të merrte aktvendim mbi

kërkesën e paditësit. Meqenëse e paditura nuk ka vepruar në përputhje me këtë detyrim, paditësi më 30.12.2020 parashtrori një kërkesë të re, duke kërkuar nga e paditura që brenda 7 ditëve të nxjerrë aktvendimin e kërkuar. Më tej, paditësi sqaroi se fatura e kontestuar është nxjerrë në bazë të një vërtetimi të gabuar të gjendjes faktike dhe një zbatimi të gabuar të së drejtës materiale duke shtuar se siç duket, e paditura nuk ka përditësuar regjistrat e saj për të evidentuar se cilat biznese nuk operojnë më në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, çka ka sjellë faturim të vazhdueshëm edhe për periudhën pas datës 01.07.2013. Ka shtuar se Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës kishte aprovuar kërkesën e paditësit për ndërrimin e selisë së tij, provë kjo e vërtetuar me dokumentin Vr.nr.1029/2023 të datës 01.11.2023. Paditësi deklaroi se nuk ka pranuar asnjë faturë apo vendim para faturës kontestuese, e cila, edhe pse përfshin tatimin vjetor për vitin 2018, përcakton një borxh paraprak në shumën prej 2,300.00 euro për një periudhë të papërcaktuar, për të cilën paditësi nuk ka pasur asnjë djeni. Gjithashtu ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i të paditurës se paditësi nuk ka ushtruar ankesë, pasi ankesa e datës 08.06.2018 është dorëzuar me postë rekomande, dhe për këtë ankesë, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.2126/18, në pikën II, ka urdhëruar të paditurën që të nxjerrë aktvendim lidhur me këtë çështje. Ndërsa lidhur me pretendimin e të së paditurës se tatimi është i detyrueshëm edhe pas ndryshimit të selisë, ky pretendim është i pabazuar, pasi që tatimi komunale aplikohet ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet afarist në territorin e komunës. Sipas Ligjit për Avokatinë, avokatët nuk kanë të drejtë të kenë më shumë se një zyrë. Gjykatës i ka që të vendosë meritorisht dhe të anulojë vendimin-faturën kontestuese, meqenëse për të njëjtën çështje ekziston një aktgjykim që ka kthyer rastin për rivendosje.

E paditura, në përgjigjen e saj të datës 02.07.2024, ka kundërshtuar tërësisht pretendimet e padisë, duke argumentuar se padia është e palejueshme, pasi është paraqitur nga një person fizik që nuk bie brenda kompetencave të kësaj gjykate. Ajo shtoi se fatura e kontestuar është lëshuar në përputhje me Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale të Komunës së Mitrovicës, në fuqi në kohën e lëshimit të faturës, ashtu siç janë faturuar të gjitha bizneset që veprojnë në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut. Gjithashtu, e paditura theksoi se paditësi nuk i ka shtuar mjetet juridike të ankimit, siç përcaktohet në nenin 9 paragrafi 3 të rregullores komunale për taksat, tarifat dhe gjobat komunale të vitit 2012. Për këtë arsye, ajo konsideron se gjykata nuk mund të vendosë meritorisht për këtë çështje. E paditura thekson se tatimi është i detyrueshëm edhe nëse biznesi e ndryshon selinë në një komunë apo qytet tjetër, sipas nenit 8 paragrafi 5 të rregullores përkatëse.

Në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor të datës 13.09.2024, Gjykata ka administruar provat relevante si në vijim: Aktgjykimi A.nr. 2126/18 dt 05.10.2020, Parashtresë e paditësit në Komunën e Mitrovicës dt 30.12.2020, Libri i pranimit , Fatura nr.18/1127 dt 30.03.2018, Ankesë e paditësit e dt 08.06.2018, Ankesë e përsëritur e datë 15.08.2018 bashkë me librin e pranimit, Certifikatë për regjistrimin e biznesit në ARBK, Vërtetim Vr.nr. 1029/2023 dt 01.11.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara, Gjykata konstatoi se e paditura, përmes faturës nr. 18/1127 të datës 30.03.2018, ka obliguar paditësin të paguajë shumën prej 200 euro për tatimin komunal vjetor për vitin 2018, përfshirë një borxh paraparak prej 2,300.00 euro, duke rezultuar në një borxh total prej 2,500.00 euro. Paditësi, më 08.06.2018, i është drejtuar Komisionit Komunal për Ankesa në Komunën e Mitrovicës, por e paditura nuk ka nxjerrë ndonjë vendim lidhur me ankesën. Më pas, paditësi me kërkesën e përsëritur të datës 15.08.2018, konform nenit 29.1 të LKA-së, i është drejtuar përsëri të paditurës, e cila sërish nuk ka marrë vendim. Si rezultat, më 03.09.2018, paditësi ka inicuar konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal, i cili me aktgjykimin A.nr.2126/18 të datës 05.10.2018, ka aprovuar kërkesën e paditësit dhe ka obliguar të paditurën të nxjerrë një vendim brenda 30 ditësh. Meqenëse e paditura nuk ka vepruar konform këtij aktgjykimi, paditësi, më 30.12.2020, i është drejtuar sërish me parashtresë të paditurës, duke kërkuar nxjerrjen e vendimit të kërkuar, por, pasi nuk mori përgjigje, ai parashtrroi këtë padi në gjykatë, duke kërkuar që fatura kontestuese të anulohet si e paligjshme.

Nga vërtetimi i lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës me nr. Vr.Nr.1029/2023, Gjykata konstatoi se Këshilli Drejtues i Odës ka aprovuar kërkesën e paditësit për ndërrimin e selisë së zyrës së tij në Prishtinë, që nga data 01.07.2013.

Pretendimet e të paditurës se paditësi nuk i ka shteruar mjetet juridike të ankimit, siç përcaktohet në nenin 9 paragrafi 3 të Rregullores Komonale për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komonale të vitit 2012, Gjykata i konsideroi të pabazuara. Nga ekzaminimi i faturës kontestuese, përkatësisht faqes së dytë të saj, rezulton se paditësi ka vepruar në përputhje me udhëzimet për ankesë, të cilat udhëzojnë tatimpaguesin, këtu paditësin, që ankesa t'i drejtohet Komisionit Komunal për Ankesa. Në bazë të kësaj, gjykata konstaton se paditësi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

Gjykata shqyrtoi gjithashtu bazën ligjore të pretenduar nga e paditura, konkretisht nenin 9 të Rregullores nr. 01/2012, sipas së cilës Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik cakton tarifën për bizneset aktive deri më 31.03 të vitit kalendarik. Subjektet afariste që kanë zhvilluar aktivitete afariste pa u ngarkuar me taksa komunale do të llogariten retroaktivisht për të gjitha periudhat ku janë zhvilluar aktivitetet. Megjithatë, kundër vendimit të lëshuar nga Drejtoria e Financave, subjektet kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë brenda 30 ditësh, e cila i drejtohet Ministrisë së Financave përmes Drejtorisë së Financave.

Në këtë drejtim, gjykata vlerësoi se, edhe nëse e paditura ka konsideruar se nuk është kompetente për shqyrtimin e ankesës, ajo ka qenë e obliguar që t'ia përcjellë atë organit kompetent, siç është rregulluar me nenin 128 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili përcakton se një ankesë duhet t'i drejtohet organit publik kompetent ose organit mbikëqyrës. Nëse ankesa i drejtohet një organi të papërshtatshëm, ajo duhet t'i përcillet organit kompetent pa vonesë.

Gjykata vlerëson se fatura kontestuese, edhe pse është bazuar në Rregulloren nr.01/2012, e njëjta nuk është përpiluar në përputhje me dispozitat e saj, të cilat përcaktojnë llogaritjen e tarifës për periudhën gjatë së cilës janë zhvilluar aktivitetet afariste, në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës. Nga provat e administruara gjykata vërteton se nuk është evidentuar periudha retroaktive, dhe nuk është dëshmuar se e paditura ka verifikuar në mënyrë të saktë gjendjen faktike. Për më tepër, nuk është dëshmuar se janë marrë prova nga Administrata Tatimore për të përcaktuar periudhën për të cilën është lëshuar fatura.

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se fatura nuk është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), vendos që fatura të anulohet si e jashtëligjshme.

Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartë cekura, si dhe nuk ka vepruar në bazë të Aktgjykimit A.nr.2126/18 të datës 05.10.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal me të cilin është obliguar që të vendos sipas ankesës së paditësit, andaj gjykata në kuptim të nenit 68 të LKA-së vendosi që të nxjerrë vendim si në dispozitiv të këtij aktgjykim ashtu që i njëjti zëvendëson aktin e organit kompetent.

Lidhur me shpenzimet procedurale si në pikën IV të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 64 të LKA-së.

Nga të cekurat më lart, gjykata bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.11 lidhur me par. 4 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.483 /22, datë 13.09.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.